Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

# RREGULLORE NR. 01/2015
# PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E VËZHGIMIT PËR EMËRIMIN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT DREJTUES

# PRAVILNIK BR.01/2015
# O PRAVILIMA I PROCEDURAMA NADGLEDANJA IMENOVANJA CIVILNIH SLUŽBENIKA RUKOVODEĆEG NIVOA

# REGULATION NO. 01/2015
# ON THE RULES AND PROCEDURES OF OBSERVATION OF APPOINTMENT PROCEDURES OF MANAGERIAL LEVEL CIVIL SERVANTS

**Prishtinë, Qershor 2015**

| | | |
|---|---|---|
| Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbështetje të nenit 10 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 dhe nenit 16 te Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 1.15 të Rregullores nr. 01/2014 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2015, miraton: | Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova na osnovu člana 10. stav 1 i podstav 1.2 i člana 16. Zakona br.03/L-192 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, kao i na osnovu člana 4. stav 1 i podstava 1.15 Pravilnika br.01/2014 o Radu Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova, na sednici održanoj dana 26.06.2015 godine, usvaja: | Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo Pursuant to Article 10, paragraph 1, sub-paragraph 1.2 and Article 16 of the Law no. 03/L-192 on the Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo, and pursuant to Article 4, paragraph 1, sub-paragraph 1.15 of the Regulation no. 01/2014 on the Work of the Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo, in a meeting held on 26.06.2015, hereby approves: |
| **RREGULLORE NR.01/2015 PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E VËZHGIMIT PËR EMËRIMIN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT DREJTUES** | **PRAVILNIK BR.01/2015 O PRAVILIMA I PROCEDURAMA NADGLEDANJA IMENOVANJA CIVILNIH SLUŽBENIKA RUKOVODEĆEG NIVOA** | **REGULATION NO. 01/2015 ON THE RULES AND PROCEDURES OF OBSERVATION OF APPOINTMENT PROCEDURES OF MANAGERIAL LEVEL CIVIL SERVANTS** |
| **Neni 1. Qëllimi** | **Član 1. Cilj** | **Article 1. Purpose** |
| Qëllimi i kësaj Rregullore është që të përcaktojë rregullat dhe procedurat e vëzhgimit të emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues si dhe detyrat dhe obligimet e Këshillit dhe institucioneve të administratës publike në procedurën e emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues. | Cilj ovog Pravilnika jeste da odredi pravila i procedure nadgledanja imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa, kao i obaveze i prava Odbora i institucija javne uprave u postupku imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | The purpose of this Regulation is to set forth the rules and procedures of observation of appointment of managerial level civil servant, and the duties and responsibilities of the Board and public administration institutions in the appointment procedures for managerial level civil servants. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Član 2.**<br>**Delokrug** | **Article 2.**<br>**Scope** |
| Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjitha procedurat e rekrutimit dhe avancimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues në të gjitha institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal. | Odredbe ovog Pravilnika sprovodi se za sve procedure regrutacije i unapređenja civilnih službenika rukovodećeg nivoa u svim institucijama javne uprave na centralnom i lokalnom nivou. | The provisions of the present Regulation shall apply to all procedures of recruitment and promotion of managerial level civil servants at all institutions of public administration, at central and local levels. |
| **Neni 3.**<br>**Obligimi i institucionit për njoftimin e Këshillit** | **Član 3.**<br>**Obaveza institucije o obaveštavanju Odbora** | **Article 3.**<br>**Duty of institutions to notify the Board** |
| 1.Çdo institucion i administratës publike icili fillon procedurën për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues është i obliguar që brenda pesë (5) ditësh nga momenti i publikimit të shpalljes së konkursit, të njoftojë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovëspër fillimin e procedurës së rekrutimit. | 1.Svaka institucija javne uprave koja započne proceduru imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa, obavezna je da u roku od pet (5) dana od momenta oglašavanja konkursa, obavesti Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova o početku procedure regrutacije. | 1. Every public administration institution aiming to initiate a proceeding for appointment of managerial level civil servants shall, within five (5) days from the publication of advertisement, notify the Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo on the initiation of recruitment proceedings. |
| 2.Njoftimi me shkrim i dërgohet Kryetarit të Këshillit dhe duhet t'i bashkëngjitet kopja e autorizimit për shpalljen e konkursit dhe kopja e konkursit te shpallur. | 2.Obaveštenje se podnosi pismenim putem i prosleđuje se predsedniku Odbora i treba mu se priložiti kopija ovlašćenja za objavljivanje konkursa i kopija objavljenog konkursa. | 2. Such notification shall be made in writing to the Chairperson of the Board, thereby attaching a copy of authorization for advertising the procedure and a copy of such advertisement. |

| | | |
|---|---|---|
| 3.Nëse zhvillimi i procedurës për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues, bëhet pa njoftim të Këshillit për pjesëmarrje në vëzhgim, Këshilli e anulon procedurën si të pavlefshme. | 3.Ako se sprovođenje procedure o imenovanju civilnih službenika rukovodećeg nivoa, uradi bez obaveštavanja Odbora o njegovom učestvovanju na nadgledanju, Odbor poništava proceduru kao nevažećom. | 3. If such procedure for appointment of managerial level civil servants is continued without presenting such notification to the Board for observation, the Board shall annul such procedure as invalid. |
| **Neni 4.**<br>**Caktimi i anëtarit të Këshillit për vëzhgim** | **Član 4.**<br>**Određivanje člana Odbora za nadgledanje** | **Article 4.**<br>**Assignment of a Board Member for observation** |
| 1.Kryetari i Këshillit në afat prej tre (3) ditë pune nga pranimi i njoftimit për shpalljen e konkursit, me vendim e cakton anëtarin e Këshillit për vëzhgimin e procedurës për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues. | 1.Predsednik Odbora, u roku od tri (3) radna dana od dana primanja obaveštenja o oglašavanju konkursa, odlukom određuje člana Odbora za nadgledanje procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | 1. The Chairperson of the Board shall, within three (3) working days from the reception of the advertisement notification, assign a member of the Board to observe the managerial level civil servant appointment procedure. |
| 2.Kryetari i Këshillit për raste të caktuara, mund të caktojë dy (2) apo më shumë anëtarë të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues. | 2.Predsednik Odbora, za pojedine slučajeve može odrediti dva (2) ili više članova Odbora za nadgledanje procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | 2. The Chairperson of the Board may, in specific circumstances, assign two (2) or more Board members to observe such managerial level civil servant appointment procedure. |
| 3.Kryetari i Këshillit e cakton anëtarin përgjegjës të Këshillit i cili e udhëheq procesin e vëzhgimit të procedurës për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues, në rastet kur caktohen dy apo më shume anëtare për vëzhgimin e një procedurë. | 3.Predsednik Odbora određuje odgovornog člana Odbora koji rukovodi procesom nadgledanja procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa, u slučajevima kada se odrede dva ili više članova za nadgledanje jedne procedure. | 3. In cases when two or more Board members are assigned to observe a procedure, the Chairperson of the Board shall also assign a Board member with the responsibility of managing managerial level civil servant appointment procedures. |

| | | |
|---|---|---|
| 4.Caktimi i anëtarit të Këshillit për vëzhgimin e procedurës së emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues bëhet në bazë të radhës. | 4.Određivanje člana Odbora za nadgledanje procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa sprovodi se prema redosledu. | 4. The assignment of Board members for observing managerial level civil servant appointment procedures shall be made on random order. |
| **Neni 5.**<br>**Përgjegjësitë e anëtarit të Këshillit**<br><br>1.Anëtari i Këshillit i caktuar për vëzhgimin e procedurës së emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues i ka këto përgjegjësi:<br><br>1.1.Udheheq procedurën e vëzhgimit në bashkëpunim me bashkëpunëtor profesional;<br><br>1.2 Në emër të Këshillit, komunikon me organin e punësimit dhe përcjell rekomandimet përkatëse gjatë zhvillimit të procedurës së emërimit;<br>1.3.Shqyrton draft-raportin e përgatitur nga bashkëpunëtori profesional dhe raportin përfundimtar me rekomandim i'a prezanton Këshillit për shqyrtim dhe miratim. | **Član 5.**<br>**Odgovornosti člana Odbora**<br><br>1.Član Odbora, određen za nadgledanje procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa, ima sledeće odgovornosti:<br>1.1.rukovodi procedurom nadgledanja u saradnji sa stručnim saradnikom;<br><br>1.2.u ime Odbora, komunicira sa organom poslodavca i prosleđuje odgovarajuće preporuke tokom sprovođenja procedure imenovanja;<br><br>1.3.razmatra nacrt- izveštaja pripremljen od stručnog saradnika i konačni izveštaj sa preporukom podnosi Odboru na razmatranje i usvajanje. | **Article 5**<br>**Duties of Board Members**<br><br>1.Board members assigned to observe managerial level civil servant appointment procedures shall have the following duties:<br><br>1.1 Manage the observation process, in collaboration with professional associates;<br><br>1.2.On behalf of the Board, communicate with employing authorities and follow up on relevant recommendations throughout the appointment procedure;<br>1.3.Review draft reports prepared by professional associate, and thereby present a final report, including recommendations, to the Board for review and approval. |

| Neni 6.<br>**Përgjegjësitë e bashkëpunëtorit profesional** | **Član 6.**<br>**Odgovornosti stručnog saradnika** | **Article 6.**<br>**Duties of professional associates** |
| --- | --- | --- |
| 1.Bashkëpuntori profesional i caktuar për vëzhgimin e procedurës së emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues i ka këto përgjegjësi: | 1.Stručni saradnik određen za nadgledanje procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa ima sledeće odgovornosti: | 1.Professional associates assigned to observe managerial level civil servant appointment procedures shall have the following duties: |
| 1.1.Ofron mbështetjen profesionale dhe administrative për anëtarin e Këshillit në procedurën e vëzhgimit; | 1.1.daje stručnu i administrativnu podršku članu Odbora u proceduri imenovanja; | 1.1. Provide professional and administrative support to the Board member assigned to the observation procedure; |
| 1.2.Sipas udhëzimeve të anëtarit të Këshillit, komunikon me organin e punësimit dhe përcjell rekomandimet përkatëse gjatë zhvillimit të procedurës së emërimit; | 1.2.shodno uputstvima člana Odbora, komunicira za organom poslodavca i prosleđuje odgovarajuće preporuke tokom sprovođenja procedure imenovanja; | 1.2.According to instructions of the Board member, communicate with employing authorities and follow up on relevant recommendations throughout the appointment procedure; |
| 1.3.Sipas udhëzimeve të anëtarit të Këshillit, përgatit draft-raportin e procedurës së vëzhgimit; | 1.3.shodno uputstvima člana Odbora, priprema nacrt-izveštaja o proceduri imenovanja; | 1.3.According to instructions of the Board member, prepare a draft report on the observation procedure; |
| 1.4.Përcjell zbatimin e vendimit/rekomandimit të Këshillit nga ana e institucionit dhe njofton me shkrim anëtarin e Këshillit për vëzhgim, Kryetarin e Këshillit dhe Drejtorin Ekzekutiv të Sekretariatit; | 1.4.prati sprovođenje odluke/preporuke Odbora od strane institucije i pismeno obaveštava člana Odbora o nadgledanju, predsednika Odbora i izvršnog direktora Sekretarijata | 1.4.Follow up on implementation of decision/recommendation of the Board by the Institution and notify in written the Board Member assigned for observation, the Chairperson of the Board, and the Executive Director of the Secretariat; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5.Përgatit njoftimin për moszbatim të vendimit/rekomandimit të Këshillit; | 1.5.priprema obaveštenje o nesprovođenju odluke/preporuke Odbora | 1.5.Prepare notifications on non-implementation of decisions/recommendations of the Board; |
| 1.6.Regjistron dhe përditëson të dhënat dhe dokumentet e procedurës se vëzhgimit në data-bazën e Këshillit. | 1.6.registruje i ažurira podatke i dokumenta o proceduri nadgledanja imenovanja u bazu podataka Odbora. | 1.6.Register and update data and documents of observation procedure with the Board database. |
| **Neni 7.**<br>**Njoftimi lidhur me procedurat e testimit** | **Član 7.**<br>**Obaveštenje u vezi sa procedurama testiranja** | **Article 7.**<br>**Notification on testing procedures** |
| 1.Institucioni i cili ka filluar procedurat për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues është i obliguar që së paku tri (3) ditë pune para mbajtjes së testimit (testimi me shkrim dhe testimi me gojë) të kandidatëve të njoftoj Këshillin, për datën, orën dhe vendin e mbajtjes së testimit të kandidatëve. | 1.Institucija koja je započela sa procedurama imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa, obavezna je da najmanje tri (3) radna dana pre održavanja testiranja (pismeno i usmeno testiranje) kandidata, obavesti Odbor o datumu, času i mestu održavanja testiranja kandidata. | 1.The institution initiating procedures for managerial level civil servant appointment shall, within at least three (3) days before the (written and oral) test of candidates, notify the Board on the date, hour and venue of testing of candidates. |
| 2.Institucioni, është i obliguar që së bashku me njoftimin për mbajtjen e testimit, Këshillit t'ia dërgoj një kopje të dosjes së procedurës së emërimit të zhvilluar deri në atë fazë. | 2.Institucija je obavezna da zajedno sa obaveštenjem o održavanju testiranja, Odboru pošalje jedan primerak dosijea o proceduri imenovanja koja je sprovedena do te faze. | 2.The Institution shall submit also a copy of the file of the appointment procedure held to that stage together with the notification on testing. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 8.**<br>**Përcaktimi i mënyrës së vëzhgimit**<br><br>Anëtari i Këshillit për vëzhgim brenda afatit prej dy (2) ditë pune nga dita e nxjerrjes së vendimit, e njofton me shkrim Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore të institucionit përkatës për mënyrën e pjesëmarrjes në procedurën e vëzhgimit të emërimit të nëpunësit civilë të nivelit drejtues. | **Član 8.**<br>**Određivanje načina nadgledanja**<br><br>Član Odbora za nadgledanje, u roku od dva (2) radna dana od dana donošenja odluke, pismeno obaveštava kadrovskog rukovodioca odgovarajuće institucije o načinu učestvovanja u proceduri imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | **Article 8.**<br>**Determination of the observation manner**<br><br>Within two (2) working days from the issuance of decision, the Board Member shall notify in written the Head of Human Resources of the respective institution on the manner of participation in the observation proceedings for the appointment of the managerial level civil servant. |
| **Neni 9.**<br>**Raporti i Këshillit gjatë zhvillimit të procedurës**<br><br>1.Anëtari i Këshillit për vëzhgim, e njofton me shkrim Këshillin lidhur me procesin e vëzhgimit në secilën fazë të procedurës, kur konstaton se procedura është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.<br><br>2.Në rastet kur konstatohet se ka shkelje gjatë zhvillimit të procedurës, Këshilli nxjerr raport, me të cilin i rekomandon Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit përkatës, që të anuloj procedurën e emërimit të nëpunësit civilë të nivelit drejtues. | **Član 9.**<br>**Izveštaj Odbora tokom sprovođenja procedure**<br><br>1.Član Odbora za nagledanje, pismeno obaveštava Odbor u vezi sa procesom nadgledanja u svakoj fazi procedure, gde konstatuje da je procedura sprovedena u suprotnosti sa zakonodavstvom na snazi.<br><br>2.U slučajevima kada se konstatuje da postoji kršenje tokom sprovođenja procedure, Odbor donosi izveštaj kojim preporučuje glavnom administrativnom službeniku odgovarajuće institucije da poništi proceduru imenovanja za civilne službenike rukovodećeg niova. | **Article 9.**<br>**Board Observation Report**<br><br>1.The observing Board member shall notify in writing the Board on the observation process at any stage when he/she deems that the procedure has been taken in contradiction with the applicable legislation.<br><br>2.In such cases of finding violations in the procedure, the Board shall issue a report, thereby recommending the Chief Administrative Office of the relevant institution to cancel the appointment procedure for the managerial level civil servant. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Raporti me rekomandim nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit.<br><br>4. Në rast se institucioni nuk e zbaton rekomandimin e Këshillit, atëherë Këshilli nxjerr Vendim përfundimtar lidhur me procedurën e emërimit për nëpunësit civilë të nivelit drejtues. | 3. Izveštaj sa preporukama potpisuje predsednik Odbora.<br><br>4. U slučaju da institucija ne sprovede preporuku Odbora, onda Odbor donosi konačnu odluku u vezi sa procedurom imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | 3. Such Recommendation Report shall be signed by the Chairperson of the Board.<br><br>4. In case of failure of the institution to implement the Board recommendations, the Board shall issue a Final Decision on the appointment procedure for the managerial level civil servant. |
| **Neni 10.**<br>**Raporti pas përfundimit të procedurës së vëzhgimit**<br><br>1.Institucioni i cili ka filluar procedurat për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues është i obliguar që pas përfundimit të procedurës së emërimit, të njoftoj Këshillin për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.<br><br>2.Anëtari i Këshillit për vëzhgim, pas pranimit të njoftimit lidhur me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshërn nga procedura e avancimit, respektivisht rekrutimit, e përgatit raportin me rekomandim lidhur me procedurën e emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues. | **Član 10.**<br>**Izveštaj nakon okončanja procedure nagledanja**<br><br>1.Institucija koja je započela procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa, obavezna je da nakon završetka procedure imenovanja obavesti Odbor o izboru uspešnog kandidata.<br><br>2.Član Odbora za nadgledanje, nakon primanja obaveštenja u vezi izbora uspešnog kandidata, procedurom unapređenja, odnosno regrutacije, priprema izveštaj sa preporukom u vezi procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | **Article 10.**<br>**Observation Completion Report**<br><br>1.Upon concluding the appointment procedure, the institution proceeding with the managerial level civil servant appointment shall notify the Board on the selection of the successful candidate.<br><br>2. Upon receiving the notification on the selection of the successful candidate in a promotion or recruitment procedure, the observing Board member shall draft a report with recommendations on the appointment procedure for the managerial level civil servant. |

| | | |
|---|---|---|
| 3.Anëtari i Këshillit për vëzhgim i'a dërgon Këshillit, raportin e procedurës së vëzhgimit së paku tri (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes së Këshillit. | 3.Član Odbora za nadgledanje, Odboru prosleđuje izveštaj o proceduri nadgledanja najmanje tri (3) dana pre održavanja sednice Odbora. | 3. The observing Board member shall submit such observation report to the Board at least three (3) days before a Board session. |
| 4.Anëtari i Këshillit për vëzhgim e paraqet raportin me rekomandim në mbledhjen e Këshillit dhe jep sqarime për të gjitha çështjet e ngritura nga Këshilli. | 4.Član Odbora za nadgledanje, podnosi izveštaj sa preporukom na sednici Odbora i daje pojašnjenja o svim pitanjima pokrenutim od Odbora. | 4. The observing Board member shall present such report before the Board and shall elaborate on any matters raised by the Board. |
| **Neni 11.**<br>**Ndërrimi i anëtarit të Këshillit për shkak të rrethanave të pa parashikuar** | **Član 11.**<br>**Zamenjivanje člana Odbora zbog nepredviđenih okolnosti** | **Article 11.**<br>**Substitution of a Board member due to unpredictable circumstances** |
| Kryetari i Këshillit ka të drejtë që të caktoj një anëtar tjetër të Këshillit për të kryer procesin e vëzhgimit në rast se anëtari i caktuar për vëzhgim për shkak të gjendjes shëndetësore, ose të paraqitjes së konfliktit të interesit, ose për ndonjë rrethanë tjetër të pa parashikuar, nuk mund të përfundoj punën e tij për vëzhgimin e procedurës për emërimin e nëpunësve civilë të nivelit drejtues. | Predsednik Odbora ima pravo da odredi jednog drugog člana Odbora radi završetka procesa nadgledanja u slučaju da određeni član za nadgledanje iz zdravstvenih razloga, ili zbog postojanja konflikta interesa ili zbog neke druge nepredviđene okolnosti ne može završiti svoj posao za nadgledanje procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | The Chairperson of the Board shall be entitled to substitute an observing Board member due to health conditions, or occurrence of conflict of interest, or any other unpredicted circumstances that arise thereby obstructing further operation in observing the appointment procedure for managerial level civil servants. |

| Neni 12. Ndryshimi i raportit me rekomandim | Član 12. Izmena izveštaja sa preporukom | Article 12. Amendment of the Recommendation Report |
|---|---|---|
| 1. Anëtari i Këshillit për vëzhgim, mund ta ndryshoj rekomandimin, nëse pas diskutimeve në mbledhje të Këshillit e vlerëson se rekomandimi duhet të ndryshohet. | 1.Član Odbora za nadgledanje, može promeniti preporuku, ako nakon diskusija na sednici Odbora oceni da se preporuka treba izmeniti. | 1.An observing Board member may amend the recommendations if so deemed necessary upon deliberations of the Board. |
| 2.Në rastet kur Këshilli nuk e aprovon raportin me rekomandim, anëtari i Këshillit për vëzhgim obligohet që të ndryshoj raportin me rekomandim në përputhje me vendimin e Këshillit. | 2.U slučaju da Odbor ne usvoji izveštaj sa preporukom, član Odbora za nadgledanje obavezuje se da izmeni izveštaj sa preporukom u skladu sa odlukom Odbora. | 2.In case the Board does not approve the Recommendation Report, the observing Board member shall amend such report to ensure compliance with the Board decision. |
| **Neni 13. Mënyra e vendosjes** | **Član 13. Načini odlučivanja** | **Article 13. Types of decisions** |
| 1.Lidhur me procedurat e emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues, Këshilli vendos në këto mënyra: | 1.U vezi procedure imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa, Odbor odlučuje na sledeće načine: | 1. In appointment procedures for managerial level civil servants, the Board may render following decisions: |
| 1.1.Aprovon procedurën e emërimit kur është në pajtim me parimet dhe rregullat e legjislacionit për shërbimin civil; | 1.1.Usvaja proceduru imenovanja kada je u skladu sa načelima i pravilima zakonodavstva civilne službe; | 1.1.Thereby approving the appointment procedure, finding compliance with principles and rules of civil service legislation; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.2.Anulon procedurën e emërimit kur është në kundërshtim me parimet dhe rregullat legjislacionit për shërbmin civil. | 1.2.Poništava proceduru imenovanja kada je u suprotnosti sa načelima i pravilima zakonodavstva civilne službe. | 1.2.Thereby annulling the appointment procedure, finding incompliance with principles and rules of civil service legislation. |
| **Neni 14.**<br>**Votimi në Këshill** | **Član 14.**<br>**Glasanje u Odboru** | **Article 14.**<br>**Voting in the Board** |
| 1.Raporti i anëtarit të Keshillit për vëzhgim, votohet në mbledhje të Këshillit.<br><br>2.Raporti me rekomandim, miratohet me votat e së paku katër (4) anëtarëve të Këshillit. | 1.Izveštaj člana Odbora za nadgledanje, glasa se na sednici Odbora.<br><br>2.Izveštaj sa preporukom, usvaja se glasovima najmanje četiri (4) člana Odbora. | 1.Observing Board member reports shall be voted in Board sessions.<br><br>2.Recommendation Reports shall be approved with at least four (4) votes of the Board members. |
| **Neni 15.**<br>**Afati për nxjerrjen e vendimit nga Këshilli** | **Član 15.**<br>**Rok za donošenje odluke Odbora** | **Article 15.**<br>**Deadlines for Board decisions** |
| 1.Këshilli në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur institucioni e ka njoftuar me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm, obligohet të nxjerr vendim për procedurën e emërimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues. | 1.U roku od trideset (30) dana od momenta kada je obavestio o izboru uspešnog kandidata, Odbor se obavezuje da donese odluku o proceduri imenovanja civilnih službenika rukovodećeg nivoa. | 1.Within a deadline of thirty (30) days from the notification on the selection of a successful candidate by the institution, the Board shall render a decision on the appointment procedure of the managerial level civil servant. |

| | | |
|---|---|---|
| 2.Me kërkesën e anëtarit të Këshillit për vëzhgim, Kryetari i Këshillit mund të zgjatë afatin edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë të tjera, vetëm në rrethanat të cilat pamundësojnë nxjerrjen e vendimit, brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni. | 2.Na zahtev člana Odbora za nadgledanje, predsednik Odbora može produžiti rok još za petnaest (15) preostalih dana, samo u okolnostima koje onemogućavaju donošenje odluke, unutar roka utvrđenog u stavu 1. ovog člana. | 2.Upon a request of an observing Board member, the Chairperson of the Board may extend the deadline for another fifteen (15) days. Such extension may be granted only in circumstances obstructing a decision within the deadline as per paragraph 1 of the present Article. |
| **Neni 16.**<br>**Hyrja në fuqi** | **Član 16.**<br>**Stupanje na snagu** | **Article 16**<br>**Entry into force** |
| Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01.08.2015 | Ovaj Pravilnik stupa na snagu 01.08.2015.godine. | This Regulation shall enter into force on 01.08.2015. |
| **Lulzim ALIAJ, Kryetar**<br>________________<br>**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**<br>**Datë: 26.06.2015** | **Lulzim ALIAJ, Predsednik**<br>________________<br>**Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova**<br>**Dana: 26.06.2015** | **Lulzim ALIAJ, Chairperson**<br>________________<br>**Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo**<br>**Date:26.06.2015** |